

## STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

### *"IPPOCRATES DIAGNOSTIC CENTER"*

Ne Sarande sot date 05.11.2019, ne respektim te kerkesave te Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2013 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", ne te nenshkruarit:

- Jani Leli, i biri i Mihal-it, i datelindjes 16 Maj 1987, Shtetas Shqiptar, mbajtes i ID nr. I70516052A me date leshimi 03/02/2015, lindur ne Kuç , te rrethit Vlore, dhe banues ne Kuç Bashkia Himare, rrethi Vlore dhe,
- Georgios Gkouvas, i biri i Anastasios, Shtetas i Republikes se Greqisë, i datelindjes 28 Shkurt 1975, mbajttese e ID: **AN 838494** , banues ne Ioannina-Psaron nr.1-3, shpall themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, si me poshtë vijon:

Neni 1

**Shoqeria quhet "IPPOCRATES DIAGNOSTIC CENTER" shpk (shoqeri me pergjegjesi te kufizuar)**

Neni 2

### **SELIA E SHOQËRISË**

Selia zyrtare e shoqerise eshte ne Sarande, lagjia nr. 3, Rruga "Lefter Talo" Godina nr. 11, kati pare, Bashkia Sarande.

Me vendim te Asamblese se Ortakeve, selia e shoqerise mund te transferohet ne nje rajon tjeter brenda territorit te Republikes se Shqiperise. Gjithashtu, shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise apo dhe jashte tij.

Neni 3

### **KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE**

Kohëzgjatja e veprimtarisë se Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon qe prej datës se regjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Biznesit.



#### Neni 4

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË SE SHOQËRISË

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

**Sherbime ne fushen e Shendetit Publik, Laborator Klinik Biokimik microbiologjik, dhe analiza te tjera ne fushen e ruajtjes se shendetit publik.**

Shoqeria mund te ushtroje cdo veprimatri tjeter tregtare dhe prodhuese e cila nuk ndalohet me ligj. (Neni 7 i Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare").

#### Neni 5

Kjo shoqëri mund te ndryshoje emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve te organeve drejtuese te kësaj shoqërie.

#### Neni 6

### KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100.000 Leke, perbehet nga dy pjese te bararabarta prej 50.000 leke secila dhe zoterohet:

- Jani Leli, nje pjese ne shumen e 50.000 leke, ose 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.
- Georgios Gkouvas, nje pjese ne shumen e 50.000 leke, ose 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

#### Neni 7

Kapitali i shoqërisë mund të rritet ne te ardhmen, nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes se kuotave te reja nga ortake te rinj, vetëm me vendim unanim te Asamblese se Ortakeve te shoqerise , ku do të miratohet si rritja e kapitalit themeltar ashtu dhe hyrja e ortakeve të ri. Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te gjithë ortakeve.

#### Neni 8

Zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë do te realizohet duke u bazuar ne dispozitat e veçanta qe parashikohen nga Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare"



## Neni 9

### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe përmban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne datën e regjistrimit ne Qenden Kombetare te Regjistrimit.

## Neni 10

Ortakët e shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit te derdhur prej tyre nuk mund t'a tërheqin. Kjo mund te behet vetëm pasi te nxirret bilanci i shoqërisë për fitimin e realizuar.

## Neni 11

Kuotat e çdo anëtari përputhen me pjesën e tyre ne kapitalin e shoqërisë. Kuotat e tij anëtari i shoqërisë mund t'ua ofroje te treteve. Anëtarët e shoqërisë kane përparësi për blerjen e kuotave përpara personave te trete jashtë shoqërisë. Ortaku qe dëshiron te transferoje ose te shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet te jete i arsyeshëm dhe te jete i njëjte me atë qe do t'i ofrohet dhe një personi te trete jashtë shoqërisë si dhe te dhënat e blerësit. Organi administrativ jep përgjigje brenda 30 ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t'ua transmetoje ortakeve te tjerë këtë kërkesë dhe ortakët e tjerë duhet te japin nje përgjigje brenda 3 muajve. Edhe e drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave duhet te ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Organit Administrativ.

E drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave është ne proporcion me kuotat qe zotëron secili prej ortakeve ne këtë shoqëri. Organi Administrativ pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut qe shet kuotat e tij vendimin e ortakeve te tjerë per te blere te gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Ne rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë këto kuota brenda 90 ditëve i ofrohen personave te trete jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet te bëhen me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet te depozitohet ne librin e Ortakeve.

Te gjitha transferimet e kuotave kane efekt mbi shoqërinë qe nga momenti i regjistrimit ne librin e Ortakeve dhe ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

## Neni 12

Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratoreve, si dhe emrat e Ortakeve duhet te jene te përmendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe qe ju drejtohen te tretëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi te zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.



### **Neni 13**

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetë të drejtat dhe detyrimet kontraktuale dhe jashtë kontraktuale. Ortaket e shoqërisë drejtojnë procesin për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë si dhe për detyrimet që ka shoqëria ndaj të tretëve pa asnjë kufizim.

Organet e shoqërisë janë:

**1- Asambleja e Ortakeve të shoqërisë.**

**2- Administratori.**

### **Neni 14**

#### **A S A M B L E J A E O R T A K E V E**

Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Asambleja e ortakëve thirret nga administratori apo nga ortaket e percaktuar sipas nenit 84 të ligjit 9901. Anëtarët duhet të njoftohen jo më vonë se 7 dite përpara datës së parashikuar dhe në lajmërim duhet të jete shkruar vendi, ora dhe çështjet që do të trajtohen. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës.

### **Neni 15**

#### **TE DREJTAT E ASAMBLESË**

Asambleja e ortakëve ka kompetencat e mëposhtme:

- Ka të drejtë të bëjë ndryshime në statut në rast kur janë dakord ortaket që përfaqësojnë tre të katërtat e kapitalit themeltar.
- Ka të drejtë të miratojë bilancin e shoqërisë dhe të bëjë ndarjen e fitimit.
- Ajo emëron administratorët, zëvendësin, ekspertët dhe revizorët kontabël.
- Ajo ka të drejtë të bëjë përjashtimin e një ortaku nga shoqëria për rastet e parashikuara në ligj si dhe në rregulloren e brendshme të shoqërisë.
- Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar që me ligj dhe me marrëveshje lihet në kompetencë të Asamblesë.
- Përcakton shpërblimin për administratorët, ekspertët, revizorët kontabël.
- Ben transferimin e kuotave të të tretët.
- Ben lidhjen e kontratave për dhënie dhe marrje të drejtash ose ekskluzivitet për tregtimin dhe prodhimin e mallrave të shoqërisë si dhe kontrata në lidhje me organet shtetërore për pjesëmarrjen në tender, ankande ose aktivitete të tjera të rëndësishme.
- Realizon blerje, shitje si dhe tjetërsim të pasurive të paluajtshme të shoqërisë etj.
- Ka të drejtë të bëjë modifikimin e kontratës së shoqërisë.



## Neni 16

- Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
- Asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

## Neni 17

Kur pjesëmarrja në asamble është normale vendimet që merren brenda kufijve të kontratës së themelimit, Statutit e të ligjeve janë të detyrueshme për të gjithë, edhe për ata që nuk kanë diskutuar edhe për ata që nuk janë dakord.

Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër që nuk është administrator. Asnjë i dërguar nuk mund të përfaqësojë më shumë se një ortak.

Në Asambleshën e Ortakeve marrin pjesë nëse është e nevojshme për të dhënë mendim pa të drejtë vote eksperte, revizore etj.

## Neni 18

Asambleja merr vendime të vlefshme në rastet e parashikuara më poshtë:

a) Në thirrjen e parë (mbledhjen e parë) në praninë e ortakeve që janë vetë prezent ose të përfaqësuar nga persona të tretë me prokurë të posaçme dhe që zotërojnë më shumë se 1/2 e kapitalit themeltar.

b) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e

përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që


zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë

për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë

vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë

të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit 9901.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të



përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

c) Për ndryshimet ne Statut vendos Asambleja e Shoqërisë Jashtëzakonshme e ortakeve e cila merr vendime të vlefshme vetëm ne rast se këto vendime do të votohen nga sipas neneit 86 të Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

### **Neni 19**

Marrja e vendimeve të Asamblesë, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me të duhet të bëhen sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

### **Neni 20**

## **ADMINISTRIMI**

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili caktohet në statutin e shoqërisë dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori/et qëndrojnë në detyrë për një periudhë kohore prej 5 vjet dhe në rast se gjatë kësaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e secilit prej tyre, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit përkatës duke treguar me fakte demin që i është shkaktuar shoqërisë nga paaftësia e tij pasi është dhënë mendimi për këtë dem edhe nga specialistet përkatës.

Ata kanë të gjitha kompetencat për të vepruar me të tretet në emër të shoqërisë dhe në interes të saj në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe Statuti i shoqërisë u'a jep shprehimisht ortakeve.

Administratori/et kanë të drejtë që të gjitha kompetencat e përmendura më sipër t'i ushtrojnë së bashku apo veç e veç duke qenë përgjegjës individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë apo të tremeve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Ata nuk mund të marrin vendime të rëndësishme siç janë huatë, të shesin pronat e shoqërisë, apo të bëhen dorëzues në emër të saj. Ata nuk mund të kryejnë veprime të cilat i lihen në kompetencë Asamblesë së Ortakeve.

Asambleja mund të vendosë lejimin e një shpërblimi në favor të Administratorit për kryerjen e detyrës përveç pagimit të shpenzimeve.

Bashkeadministrator të shoqërisë janë **z. Jani Leli dhe Georgios Gkouvas.**

### **Neni 21**

Administratori/et mund të emërojë një ose më shumë administratore të deleguar ose përfaqësues të thjeshtë për të kryer veprime të veçanta duke përcaktuar fuqinë e tyre brenda kufijve e duke e respektuar statutin dhe ligjet në fuqi dhe vendos dhënien e një shpërblimi në favor të tij. Detyrat e tyre do të përcaktohen në një rregullore të brendshme të shoqërisë.

### **Neni 22**



Administratoret kane liri te plote për drejtimin e zakonshëm dhe te jashtëzakonshëm te shoqërisë dhe mund te kryejnë te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marrëveshje per realizimin e qëllimeve te shoqërisë duke përjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojnë Asamblesë se Ortakeve.

#### **Neni 23**

Administratoret kane te drejte te nënshkruajnë për kapitalin e shoqërisë, kontrata te ndryshme, per furnizime publike private, te ndërmarrin veprime gjyqësore per dhe ne emër te shoqërisë, etj. Administratori mund te japin prokura ne kufijtë qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh.

Administratoret janë te detyruar te mbajnë regjistrat e magazinimit te cilat vihen ne dispozicion te organeve kopetente per te mundësuar kryerjen e kontrolleve prej saj. Administratoret e shoqërisë jane te detyruar te mbajnë inventar te rregullta nje here ne muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratoret.

#### **Neni 24**

### **MARRËDHËNIET E PUNËS**

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës se punës dhe legjislacionit te punës ne fuqi. Shoqëria private merr përsipër te respektoje rregullat ne fuqi te punësimit dhe te punësuarit jane te detyruar qe te respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punësuarit duhet te përgjigjen per demet qe i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

#### **Neni 25**

### **KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike përmbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe jane përcaktuar si te tilla nga administratoret e kësaj shoqërie.

#### **Neni 26**

### **EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABËL**

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithe aktivitetin e shoqërisë i besohet nje eksperti ose revizori kontabël. Ky ekspert do te qëndroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

#### **Neni 27**



## BILANCI DHE FITIMET

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi veçohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

### Neni 28

Ne rast se kapitali i shoqërisë per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve për mundësinë e prishjes se shoqërisë.

### Neni 29

## SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Ne rast se shoqëria prishet per cdo lloj arsye Asambleja e Ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron nje ose me teper likuidator dhe përgatit te gjitha dokumentet e nevojshme për çregjistrimin e saj nga Regjistri Tregtar.

### Neni 30

## DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Për sa është shprehur ne këtë statut i referohemi Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Statutit dhe rregullores se brendshme te shoqërisë. Çdo ndryshim behet ne te njëjtën mënyre siç është nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kësaj shoqërie.


Ky statut nënshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqërisë ne Sarande , sot me

**05.11.2019**

*ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE "IPPOCRATES DIAGNOSTIC CENTER" SH.P.K.*

Jani Leli

JANI LELI



Georgios Gkouvas

